

**VENDIM**  
**Nr. 92, datë 4.2.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 945, DATË 9.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 945, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“II. Ministria e Mjedisit harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave si dhe monitorimin e cilësisë së ujërave.”.

2. Në pikën 1, të paragrafit III, pas fjalëve “...monitorimin e treguesve të mjedisit” shtohen fjalët “...dhe të cilësisë së ujërave...”.

3. Pika 3, e paragrafit III, shfuqizohet.

4. Pika 4, e paragrafit III, numërtohet pika 3.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**